



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit për financat e pushtetit lokal Nr. 03/L-049 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E PROJEKT - RREGULLORES PËR
NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR TAKSAT KOMUNALE
15NR.011-23131 E DATËS 06.05.2015

Neni 1

Përbërja

Formohet Komisioni për hartimin e Projektit të Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksat komunale 15Nr.011-23131 e datës 06.05.2015, në vazhdim të tekstit Komisioni, në përbërje si vijon:

1. Fauzë Xhemajli , Drejtorati për Administratë, Kryesues
2. Vlora Krasniqi, Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore, anëtare
3. Hanushe Berisha, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtare
4. Rafete Retkoceri, Drejtorati për Shërbime Publike, anëtare
5. Burim Dedushi, Drejtorati për Inspektorat, anëtar

Neni 2

Detyrat , përgjegjësitë dhe puna e Komisionit

Komisioni ka për detyrë që duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për financat e pushtetit lokal dhe dispozitat tjera ligjore të cilat i japin kompetencë Komunës caktimin e taksave, të pregadisë Projektin e Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksat komunale duke u konsultuar paraprakisht me të gjitha Drejtoratet Komunale më së largu deri me datën 25.03.2016 .

Komisioni do të fillojë punën në Zyrën e Drejtorit për Administratë menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit .

1Nr. -011-9216
Lipjan, më 24.02.2016

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

